

8018/6 puf-



EKR EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR  
HIDAJETE KRAJA (MUÇAJ)

NR. LICENCE 107, datë 21/12/2000

---

## RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga  
Partia "Komuniste Shqiptare" (P.K.SH)

Periudha 01.01.2014 – 31.12.2014



## RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

### KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

#### TIRANË

Të nderuar zotërinj!

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin numër 969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe të kontratës të shërbimit lidhur me të me numër protokollit të sajin 7702, datë 29.09.2015, kam audituar pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara për vitin 2014 të Partisë "Komuniste Shqiptare" (P.K.SH).

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të partisë "Komuniste Shqiptare" (P.K.SH). Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në zbatim të kërkesave të Standarteve Ndërkombetare të Auditimit, në referencë të veçantë me SNA-në 800: "Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike".

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketimit pagesave.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.



EKR EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR  
HIDAJETE KRAJA (MUÇAJ)

NR. LICENCE 107, datë 21/12/2000

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

Për mendimin tim, pasqyrat bashkëlidhëdhur dt.19.06.2015 e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjate vitit 2014 të Partisë Komuniste Shqiptare (P.K.SH) që fillon me dt.01.01.2014 dhe mbyllet me dt.31.12.2014 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtive dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

HIDAJETE KRAJA (MUÇAJ)

EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR

Shkodër, më

10.12.2015